

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenet 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / VELOZAR RAZVITRANJE NABAVKI
Nr/Br. 5018
Data/Datum. 02.02.18
PRISHTINË - PRIŠTINA

Një ankesë kundër: **Policia e Kosoves**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **214/16/114/211**

Sa i përket tenderit për: **SHËRBIMET E SIGURIMIT TPL, TPL PLUS DHE KASKO PËR AUTOMJETET E PK-SË**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Pashko Vasa P.N

(Adresa)

Prishtine

10000

(Vendi)

(Kodi postar)

038

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Mal Berisha

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

(Adresa elektronike)

02.02.2018


(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me **PROKURË**.



Kjo mosperputhje e veprimeve verteton se kerkesa per rishqyrtim fare nuk eshte trajtuar nga autoriteti kontraktues dhe se me shume nguti eshte vendosur kinse per refuzimin e pretendimeve te bazuara OE SIGAL UNIQA.

Me tutje, me date 29.01.2018, pra tre (3) dite pas refuzimit te kerkeses per rishqyrtim (te trajtuar si ankese nga AK) te dates 26.01.2018, AK ka derguar OE SIGAL UNIQA "Njoftim mbi pezullimin e aktivitetit te prokurimit", qe eshte ne kundershtrim te plote me dispozitat e nenit 108/A par. 2 te LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- Shkelje e nenit 7 të LPP-së, Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi,
- Shkelje e nenit 51 par. 1, 2 pika (ii) dhe 3 të LPP-së, Kriteret e Përzgjedhjes,
- Shkelje e nenit 54, Njoftimi i Kandidatëve dhe Tenderuesve të Eliminuar,
- Shkelje e nenit 56 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe pika 3 të LPP-së, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave,
- Shkelje e nenit 59 të LPP-së, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve,
- Shkelje e nenit 65 të LPP-së, Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve,

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjohë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. Autoriteti Kontraktues Policia e Kosoves (me tutje referuar si AK) ne vleresim te tendereve te derguar sipas aktivitetit te prokurimit objekt i kesaj ankese, ka kerkuar nga Banka Qendrore e Kosoves te dhenat mbi miratimin e tarifave te aplikueshme per produktin TPL, shprehimisht ne grupin tarifar V qe i referohet sigurimit te motoçikletave per cka ka ardhë ne perfundim se oferta e dhene nga Operatori Ekonomike SIGAL UNIQA Group Austria sh.a. (me tutje referuar si OE), per sigurimit me TPL + te nje motoçiklete te AK-se eshte ne shume prej 45.24 €, ndersa si tarife ne fuqi eshte shuma prej 46.02 €.

AK-se i sqarojme se nje ndryshim i tille vjen sipas nje leshimi te perlllogaritjes se normes se TVSH-se se aplikueshme ne primin baze te ketij produkti TPL, per sigurimit e motoçikletesë, me saktesisht ne llogaritjen e primit per sigurimit TPL+, ne rastin konkret.